REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 2023 10255
Data/Datum 12.06.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0255

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi-Kryetar,duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.P.T. "Printeks", me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me veshëmbathje për balerinet e BKK-së" me nr. të prokurimit: 207-23-2900-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Kulturës Rinisë Sportit dhe ÇJK, me 12/06/2023, mori:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.P.T."Printeks" me nr. 2023/0255,e datës 04/05/2023, kurse vendimi i AK Ministria e Kulturës Rinisë Sportit dhe ÇJK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me veshmbathje për balerinët e BKK-së" me numër të prokurimit 207-23-2900-1-3-6 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.P.T. "Printeks"

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.03.2023, Ministria e Kulturës Rinisë Sportit dhe ÇJK, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar, Njoftimin për Kontratë. Me datë 18.04.2023,AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin të prokurimit "Furnizim me veshëmbathje për balerinet e BKK-së" me nr. të prokurimit: 207-23-2900-1-3-6,ku është

rekomanduar për kontratë OE "E3 Group" sh.p.k me seli në Prishtinë. Me datë 24.04.2023, Operatori Ekonomik N.P.T."Printeks" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Ministria e Kulturës Rinisë Sportit dhe ÇJK, me datë 24.04.2023, AK e ka refuzuar, si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 18.04.2023, për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.Me datën 04.05.2023, Operatori Ekonomik "N.P.T."Printeks" ka parashtruar ankesë në OSHP-së, me numër të protokollit 255/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim-blerje, vlera e parashikuar e kontratës: 7,500.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 15 maj 2023 me raportin e ekspertizës. AK Ministria e Kulturës Rinisë Sportit dhe ÇJK, nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq me datë 26 maj 2023 OE N.P.T."Printeks" me seli në Prizren, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 15.05.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "N.P.T."Printeks" me seli në Prizren, të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 18.04.2023 dhe lënda të kthehet në rivlerësim (njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues</u>

OE ankues NTP "Printeks" pretendon që është eliminuar pa arsye nga procedura e prokurimit të tenderit në fjalë dhe se arsyetimi i dhënë nga AK se OE ankues nuk ka ofruar mjaftueshëm dëshmi për kontrata të ngjashme nuk qëndron sipas OE N.P.T."Printeks" Prizren. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese dhe dosjes së tenderit e po ashtu edhe dëshmive dhe ofertave të dërguara nga operatoret ekonomik eksperti shqyrtues vëren se:

Përgjigje në pretendim:

Ankesa e OE ankues N.P.T."Printeks" -Prizren sipas eksperti konsiderohet se është e bazuar ngase në ofertën e saj operatori në fjalë ka dërguar mjaftueshëm dëshmi, kontrata, fatura të dërgesave të natyrës së ngjashme(materiale,rroba etj) dhe eksperti konsideron diskriminuese përgjigjen e AK kinse ka mungesë të kontratave të ngjashme në bazë të kërkesës dhe dosjes së tenderit. Sikur edhe shohim më poshtë OE ankues po ashtu ka nënshkruar deklaratën nën betim se i përmbahet kushteve dhe specifikave të tenderit të shpallur. Në anën tjetër arsyetimi i AK me rastin e eliminimit të këtij OE për ekspertin shqyrtues është i pabazuar ngase në dosje të tenderit kërkohet Lënda: Furnizim me veshëmbathje për balerinët e BKK-së. Edhe pse ne seksionin II, tek formulari i përshkrimit të çmimit janë të specifikuara llojet e produktit por nëse do duhej të ishin shumë specifike dhe të veçanta sikur në arsyetimin e AK-se, eksperti konsideron që në Dosje të tenderit do duhej të kërkohej katalogu ose mostra, përmbajtja e materialeve etj, për ta vlerësuar më saktë llojin e produktit të kërkuar nga ofertat e marra. Meqenëse, këto kërkesa dhe specifika teknike në këtë format i japin dhe lënë hapësire për diskutime dhe mëdyshje të tilla, OE u është lejuar hapësire qe të japin ofertat e tyre të pa definuara dhe gjenerale ndaj këtyre produkteve, materialeve apo edhe kualitetit të kërkuar. Andaj konsiderojmë që AK nuk i ka precizuar qartë parametrat e blerjes së propozuar. Kjo përshkruhet shumë qartë dhe mirë në rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik pika 17.22.1 Furnizimet ku mes tjerash thuhet:

17.22.1 Furnizimet: 1.Një deklaratë e kërkesave për prokurimin e furnizimeve do të përmbajë përshkrime të plota, të sakta dhe precize të furnizimeve, orar të dorëzimit dhe përfundimit, listë të furnizimeve dhe sasive, specifikime teknike dhe projektime, dhe do të përfshijë sipas nevojës: a. përkufizim të qartë të parametrave të blerjes së propozuar; b. qëllimin dhe objektivat e blerjes së propozuar; c. përshkrim të plotë të kërkesës; d. specifikim të përgjithshme në nivel të mjaftueshëm të detajeve; e. përshkrim funksional të cilësive, përfshirë veçori të kërkuara mjedisore apo të sigurisë të lëndës së prokurimit; f. parametra të performancës, përfshirë rezultatet, afatet kohore, dhe çdo indikator tjetër ose kritere me të cilat përformanca e kënaqshme e specifikimeve mund të vlerësohet; g. përshkrimi i procesit dhe materialeve; h. kërkesat të dimensionet, simbolet, terminologjia, gjuha, paketimi, shënimi dhe etiketimi; i. një standard i përbashkët i specifikimeve j. standardin relevant të industrisë; dhe k. çdo informatë tjetër relevante.

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat ZD)
1	Mbathje te buta te baletit (mbatije te cilat ju sherbejne balerineve për ushtrime, prova dhe shfaqjet e baletit) numrave te ndryshem	pale	69	
2	Warm Shoes (mbatije per ruajtjen e temperaturave optimale te kembeve te balerineve gjate pauses ne prova) numrave te ndryshem	pale	23	
3	Veshje te brendshme (qe ju sherbejne balerineve për veshjen e tyre me kostumin e shfaqjes) numrave te ndryshem	pale	23	
4	Veshje te jashtme me logo te BKK-Uniforme (qe ju sherbejne për ushtrime dhe udhetime zyrtare) numra te ndryshem	pale	23	
				Totali i PËRGJITHSHËM

NPT PRINTEKS me certifikat regjistrimit 811294199

DEKLARAT ME SHKRIM

Me anë tëkësaj shkruajmë kompania NPT PRINTEKS me nr. Unifikues 811294199

deklarojm se na do tu pambahemi kushteve, specifikave teknike dhe afatit të liferimit sipas dosjes së tenderit të shpallur nga Autoriteti Kontraktues:

Nr. i Prokurimit	207-23-2900-1-3-6
Nr. i Referencës	207-23-010-1-3-6

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Titulli: furnizim me veshëmbathje per balerinet e BKK-së

DEKLAROJM ME PËRGJEGJËSI TË PLOTË SE TË GJITHË ARTIKUJT E OFRUAR NGA KOMPANIA JANË KONFORM SPECIFIKAVE TEKNIKE TË EKRUARA NË ANEKSIN 1 TË DOSJES SE TENDERIT DHE

Afati i Liferimit (Dorzimit tu Mallit) është 30 dite prej datës së pranimit kerkesës prej AK-s ose Menagjeri Kontrates

Perfaqësuar nga:

NAIM SHUKI

01.04.2023

Përgjigjja e AK kundrejt OE ankues mbi arsyen e eliminimit:

<u>Të Kërkesat e paraqitura nga AK-MKRS, Operatori Ekonomik</u> N.P.T."PRINTEKS", 1, ADEM JASHARI, -20000, PRIZREN, Kosovë, <u>nuk plotëson kriteret:</u>

- Sipas kriteri: Operatori ekonomik duhet të dëshmojë me kontrata ose faturë me reference ose certifikatë përfundimtare e pranimit që ka kryer se paku një furnizim të ngjashëm ne 3 vitet e fundit në vlerë së paku 10 000.00€ (nga data e publikimit të B05). Operatori Ekonomik N.P.T."PRINTEKS" nuk ka prezantuar kontrata të natyres së ngjashme specifike, ku të gjitha furnizimet e paraqitura nga ana e OE janë furnizime si uniforma punc të kompanive, uniforma ushtrake, uniforma të zjarrëfikeseve dhe uniforma tjera të MPB, dhe duke e ditur që furnizimet e kërkuara nga ana e AK janë specifike, AK dhe komisioni vlerësues paraqet se i njëjti nuk ka paraqitur kontrata të natyrës se ngjashme.

Çmimet e ofruara për secilin artikull veç e veç nga OE ankues N.P.T "Printeks", Prizren.



REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura si dhe çmimin prej 2339.10 euro më të lirë se OE i propozuar për kontratë. eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues e vlerëson si të qëndrushme ankesa e OE ankues pasi që në ofertën e tijë operatori ankues në fjalë ka dërguar mjaftueshëm dëshmi,për AK siq janë kontrata, fatura të dërgesave të natyrës së ngjashme(materiale,rroba etj). OE ankues po ashtu e ka nënshkruar deklaratën nën betim se i përmbahet kushteve dhe specifikave të tenderit të shpallur,ndërsa në anën tjetër arsyetimi i AK me rastin e eliminimit të këtij OE N.P.T."Printeks" është i paqëndrushëm pasi siq shihet në dosje të tenderit është kërkuar nga autoriteti kontraktues - Furnizim me veshëmbathje për balerinët e BKK-së.

Paneli shqzrtues konsideron se në dosje të tenderit AK do duhej të kërkohej katalogu ose mostra, përmbajtja e materialeve etj, për ta vlerësuar më saktë llojin e produktit të kërkuar nga ofertat e marra, ngase me kërkesat dhe specifika teknike që i ka kërkuar AK i japin dhe lënë hapësirë për diskutime dhe mëdyshje të tilla, OE-ve iu është lejuar hapësirë që të japin ofertat e tyre të pa definuara dhe gjenerale ndaj këtyre produkteve, materialeve apo edhe kualitetit të kërkuar. Andaj paneli shqyrtues vlerëson se AK nuk i ka precizuar qartë parametrat e blerjes së propozuar,ashtu siq parashihet me rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik pika 17.22.1.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE "N.P.T. "Printeks", të aprovohet si e bazuar, si dhe konform mendimit të raportit të ekspertit shqyrtues të anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së, për dhënie të kontratës të datës 18.04.2023, dhe aktiviteti i prokurimit përshkruar si më sipër të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe

rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **N.P.T."PRINTEKS"**
- Arkivës së OSHP-së: